

VENDIM
Nr.16, datë 28.4.2020

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS ME PERSONEL INFERMIER PËR REPUBLIKËN
E ITALISË**

Në mbështetje të nenit 35, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, në vijim të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Komiteti Ndërmintoror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 28.4.2020,

VENDOSI:

1. Propozomin për miratim në Këshillin e Ministrave të dhënies së ndihmës me 60 vetë, personel infermier, Republikës së Italisë, në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Shpërblimi i infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, të jetë 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro në muaj.

3. Fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e personelit infermier, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

4. Të ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të bëjë përzgjedhjen e infermierëve të cilët do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të sigurojnë transportin e personelit infermier drejt Italisë.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama**

PROJEKTVENDIM
**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS ME PERSONEL INFERMIER PËR REPUBLIKËN
E ITALISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 35, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës me 60 vetë, personel infermierë, në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, Republikës së Italisë.

2. Shpërblimi i infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, është 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro në muaj.

3. Fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e personelit infermier, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të bëjë përzgjedhjen e infermierëve të cilët do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të sigurojnë transportin e personelit infermierë drejt Italisë.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.